

Rezultatet e konsultimeve publike për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021- 2027”

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021- 2027”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Hartimi i Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 – 2027 ka filluar me ngritjen e Grupit të Punës me datë 5.2.2022 dhe është hartuar me mbështetjen e ekspertëve të GIZ. Për hartimin e strategjisë janë ngritur edhe grupet teknike të punës sipas objektivave të strategjisë, ku anëtarë të këtyre grupeve ishin:

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së, AKU, AKVMB, etj.;
- Përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Përfaqësues të Univesitetit Bujqësor;
- Përfaqësues të Grupeve të interesit, si më poshtë:
 - Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
 - ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
 - ADAD Malore;
 - AFI – Albanian Food Industri;
 - ADAMA – Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit;

Hartimi i strategjisë ka qenë gjatë gjithë kohës në konsultim me grupet e interesit duke qenë se grupet e interesit kanë qenë pjesë e grupeve teknike të punës të përfshira në hartimin e strategjisë.

Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të strategjisë përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data **30.07.2021 deri më 04.05.2022**. Në këtë afat përfshihen edhe takimet me grupet e interesit edhe konsultimi përmes regjistrimit elektronik.

Procesi i konsultimit përmes regjistrimit elektronik në RENJK zgjati nga data 01.04.2022 deri më 04.05.2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021- 2027", ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK, nga data 01.04.2022 deri më 04.05.2022;
- komunikimi përmes postës elektronike gjatë gjithë fazës së hartimit të strategjisë;
- takime të vazhdueshme (edhe online) me ekspertët e huaj dhe grupet teknike të punës, grupet e interesit, subjekte të ndryshme që operojnë në fushën e bujqësisë, etj..
- Takim me grupet teknike, përfshirë grupet e interesit pjesë e grupeve teknike, me datë 31.05.2021, 13 – 17 shtator 2021, etj.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në hartimin e strategjisë, janë:

- Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
- ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- ADAD Malore;
- AFI – Albanian Food Industri;
- ADAMA – Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit
- IBB – Instituti i Bujqësisë Organike

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Duke qenë se procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces dinamik dhe grupet e interesit kanë qenë të përfshira në hartimin e dokumentit komentet/sugjerime e tyre janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Kuai ligjor/rregullator	<p>Të përfshihet në strategji përgatitja e një kuadri rregullator të qartë dhe të përmirësuar për Zbatimin e Qasjes LEADER.</p> <p>Mbështetje në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e strukturave të menaxhimit dhe kontrollit për produktet me origjinë të mbrojtur dhe tregues gjeograik të mbrojtur, produktet tradicionle</p> <p>Ndërhyrje në disa ligje, por me një ligj të vetëm, si: Ligji i shërbimit veterinar; ligji i mbrojtjes së bimëve; ligjislacioni për biocidet; ligji për bujqësinë organike; ligji për materialin mbjellës e shumëzues.</p>	<p>ANRD</p> <p>ANRD</p> <p>Drejtoria e Sigurisë Ushqimore</p>	<p>Jo</p> <p>Po</p> <p>Po</p>	<p>MBZHR ka hartuar ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”. Ligji është miratuar në mars 2022.</p> <p>Përfshirë në planin e masave</p> <p>Përfshirë në planin e masave</p>

	Ndryshim rregullorë mbi sigurinë ushqimore	Projekti “Food Safety’	Po	Përfshirë në planin e masave
Asistencë Teknike	<p>Përfshirja e laboratorëve në Strategji. Nuk kemi kapacitete për të bërë analizimin e mostrave, si rrjedhim bëhet dërgesa e tyre në laboratorët ndërkombëtarë, gjë që ka kosto. Kemi laboratorë rajonalë dhe një laborator reference. Na duhet asistencë teknike.</p> <p>Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit RUDA, përcaktimi i kriterëve për kategorizimin e Operatorëve të Biznesit Ushqimor, etj.</p>	Drejtoria e Sigurisë Ushqimore	Po	Përfshirë në planin e masave të strategjisë.
Shërbimi Këshillimor	Ristrukturimi i kohëve të fundit dhe nevoja për konsolidimin e AREB-it duket se nuk janë përmendur ose vetëm shkurtimisht.	RTM – ANRD	Po	Përfshirë në planin e masave të strategjisë.

	<p>Duke qenë se interes i AREB është shumë i lidhur me dobësitë e tjera të adresuara në SARDF (ndërgjegjësimi mjedisor, teknologjia në bujqësi, mbledhja e të dhënave, etj.), një interes i qartë për forcimin e një interesi kaq të rëndësishme është shumë e rëndësishme.</p>			
Bujqësia Organike	<p>Nuk ka aktivitete të planifikuara në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për institucionet për të mbështetur bujqësinë organike, apo për institucionet certifikuese. Etj.</p> <p>Nuk ka mbështetje të planifikuar për shërbime këshillimore dhe kërkimore në bujqësinë biologjike.</p>	IBB – ANRD	Po	Përfshirë në planin e masave të strategjisë.
	<p>Skemat e Pagesave Direkte</p> <p>Indikatorët e Gender</p> <p>IPARD</p> <p>Peshkimi</p>	Sektori i Politikave	Pjesërisht	Përfshirë në planin e masave të strategjisë.

Tabela e komenteve sipas grupeve të interes:

Nr.	Subjektet	Data	Nr. Komentesh	Pranuar	Refuzuar	Dakortësuar
1	ANRD	2.9.2021	4	3	1	Po
2	Drejtoria e Sigurisë Ushqimore	2.9.2021	2	2	-	Po
3	Projekti Food Safety		1	1	-	Po
4	Sektori i Politikave MBZHR		15	7	8	po